



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 511/5 Prot.

Tiranë, më 22/6/2017

REKOMANDIM

Nr. 22, datë 22/6 /2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Alpha Bank" Sh.a, Tiranë;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 26.04.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Alpha Bank" Sh.a, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë përpunimit të të dhënave personale të punonjësve.

Kontrolluesi "Alpha Bank" Sh.a ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimeve financiare. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës" (punonjës) dhe "Kandidatëve për pozicionin e lirë të punës", manualisht dhe në format elektronik në rrjetin e brendshëm kompjuterik. Për këto kategori, kontrolluesi i përpunon të dhënat për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe plotësimit të vendeve të lira të punës. Të dhënat personale të punonjësve që përpunohen janë: emër, mbiemër, numër telefoni, e-mail, numri i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, jeta profesionale, imazhe nëpërmjet kamerave cctv, adresa të dhëna për shëndetin, dëshmi penaliteti, certifikatë familjare, fotografi, etj.

Përpunimin e të dhënave personale gjatë procesit të rekrutimit të punonjësve, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Kandidatëve për pozicionin e lirë të punës", kontrolluesi e fillonte me shpalljen e pozicioneve të lira të punës duke ftuar të gjithë punonjësit të shfaqin interesin e tyre. Në momentin kur nuk kishte asnjë kandidat të përshtatshëm, konsideroheshin mundësitë nga tregu. Kandidatëve të brendshëm u kërkohej të dorëzonin CV dhe formën e aplikimit kurse kandidatëve të jashtëm u kërkohej të dorëzonin vetëm CV.

1. Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ të ushtruar konstatoi se, kontrolluesi "Alpha Bank" Sh.a nuk kishte marrë masa në drejtim të informimit të subjekteve të dhënave personale (Kandidatëve për pozicionin e lirë të punës), pasi në formatin e "Njoftim për pozicion të lirë pune" nuk reflektoheshin të gjithë elementet e nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë

2. Kontrolluesi "Alpha Bank" Sh.a, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22/6 /2017

